


PRISHTINË, NËNTOR 2020

# INTEGRITETI AKADEMIK, PUBLIKIMI SHKENCOR DHE JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS



UNIVERSITETI  
I GJAKOVËS





INTEGRITETI  
AKADEMIK,  
PUBLIKIMI  
SHKENCOR DHE  
JUSTIFIKIMI  
I TITUJVE  
AKADEMIKË NË  
UNIVERSITETIN E  
GJAKOVËS

**Publikues:**

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

[www.orca-ks.org](http://www.orca-ks.org)

[info@orca-ks.org](mailto:info@orca-ks.org)

Simon Shiroka, H-11, Nr. 8

Prishtina, 10000, Kosova

**Hulumtues:**

Skord Retkoceri

**Autorë:**

Skord Retkoceri

Liridona Ademaj



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë  
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.  
Falna durimin të thellojmë një punë përpara  
se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një  
ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo  
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!  
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga  
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e  
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

# TABELA E PËRMBAJTJES

Definime.....	7
Hyrje.....	8
Të dhëna të përgjithshme të universitetit .....	9
Pasqyra akademike e Universitetit të Gjakovës.....	10
Rregullorja për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore.....	10
Numri i publikimeve shkencore në Universitetin e Gjakovës .....	11
Publikimi në revista të dyshimta .....	14
Justifikimi i titujve akademikë.....	15
Fakulteti i Edukimit.....	17
Publikimi shkencor.....	17
Justifikimi i titujve akademikë.....	18
Fakulteti i Mjekësisë.....	19
Publikimi shkencor.....	19
Justifikimi i titujve akademikë.....	20
Fakulteti i Filologjisë .....	21
Publikimi shkencor.....	21
Justifikimi i titujve akademikë.....	22
Metodologjia .....	23

# DEFINIME

Punime të vlefshme për avancim – konsiderohen punimet e publikuara në revista siç është përcaktuar me ligjet dhe rregullativat për emërim, riemërim dhe avancim të stafit akademik.

Punime shkencore – punimet ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent.

Punime në revista të dyshimta – punimet të cilat janë në revista apo në botues të listuar në listën Beall.

Justifikimi i titullit – të pasurit e numrit të nevojshëm të publikimeve shkencore për titullin përkatës sipas ligjeve dhe rregullativave në fuqi.

Burra dhe gra – Gjinia e presupozuar e personave në bazë të emrit pa paragjykuar identifikimin e tyre personal.

# HYRJE

Pas publikimit të raporteve mbi integritetin akademik dhe publikimin shkencor në Universitetin e Pejës dhe Universitetin e Prizrenit, në kuadër të projektit QAIN, ORCA ka bërë hulumtimin edhe për Universitetin e Gjakovës.

Raporti është rezultat i punës hulumtuese të bërë gjatë periudhës kohore prill - tetor 2020, ku hulumtuesit e ORCA-s shqyrtuan materialet e publikuara në CV-të e stafit akademik të Universitetit të Gjakovës me titujt profesorial: profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt. Përveç CV-ve janë hulumtuar edhe dokumentet të tjera në uebfaqe të universitetit të cilat listojnë publikimet shkencore të profesorëve.

Universiteti i Gjakovës ka publikuar Buletinin Shkencor 1, i cili është përmbledhje e punës shkencore të stafit akademik nga viti 2017. Kjo përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së transparencës në këtë universitet.

Në vitin 2020, ky universitet ka miratuar rregulloren e vetme deri tash nga ndonjë institucion i arsimit të lartë publik në Kosovë që parasheh kompensime në shuma të caktuara për punimet e publikuara në revista shkencore në platformat e përcaktuara nga rregullativat në fuqi.

Sikur edhe tek universitetet e tjera publike, edhe shumica e profesorëve në këtë universitet nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë. Përveç Fakultetit të Mjekësisë që ka numër të lartë të punimeve për kokë profesori, fakultetet tjera çalojnë në këtë drejtim. Problem tjetër është edhe publikimi në revista të dyshimta.

Një analizë e tillë mund të jetë e dobishme në planifikimin e reformave, përfshirë këtu edhe financimin e projekteve shkencore ashtu që të ketë rritje të publikimit shkencor në këtë universitet.



# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

## BUXHETI

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Gjakovës (UGJFA), janë ndarë gjithsej 2 milionë e 460 mijë e 46 euro vetëm për vitin 2019, ndërsa për vitin 2020, janë ndarë 1 milionë e 974 mijë e 755 euro, sipas gjetjeve në raportin e fundit për financa të publikuar nga ORCA<sup>1</sup>, në tetor të vitit 2020.

## STUDENTËT

Universiteti i Gjakovës, në nivelin Bachelor ka gjithsej 1 mijë e 653 studentë. Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 1 mijë e 399 femra dhe 254 meshkuj. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar në vitin akademik 2019/2020, janë gjithsej 318 femra dhe 63 meshkuj, pra 381 të diplomuar. Raporti student-mësimdhënës në këtë universitet është 33:1.

## TRANSPARENCA FORMALE

Në faqen zyrtare të Universitetit të Gjakovës, në shtator të vitit 2020, ORCA kishte gjetur se janë të publikuara gjithsej 25 nga gjithsej 27 dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit<sup>2</sup>. Kjo shënon rritje nga matja e parë e bërë në shkurt të vitit 2019 kur kishte vetëm 15 dokumente publike.

<sup>1</sup> Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: Menaxhimi i Financave", 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Menaxhimi-i-financave-2.pdf>

<sup>2</sup> Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: (Mos)informimi i publikut", 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>

# PASQYRA AKADEMIKE E UNIVERSITETIT TË GJAKOVËS

Universiteti i Gjakovës ka 26 profesorë që janë evidentuar përmes CV-ve të publikuara në uebfaqen e universitetit. Prej tyre 7 janë gra dhe 19 janë burra. Një profesor është i rregullt, 12 janë profesorë të asocuar dhe 13 janë profesorë asistentë.

## PRAKTIKË E MIRË NË RRRITJEN E NUMRIT TË PUBLIKIMEVE SHKENCORE - RREGULLORJA PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE-SHKENCORE E UNIVERSITETIT TË GJAKOVËS

Në shkurt të vitit 2020, ky universitet ka miratuar Rregulloren për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore<sup>3</sup>. Në Nenin 9 të kësaj rregullore, është paraparë që hulumtuesit më të mirë vjetor të stimulohen me një pagë sipas thirrjes akademike.

Ndërkohë që sipas Nenit 12, botimi në revista shkencore ndërkombëtare financohet nga vetë universiteti, pas aprovimit nga Komisioni për kërkime shkencore. Financimi për punime shkencore është i kategorizuar në dy pika: Botimi në revista ndërkombëtare të indeksuara sipas Udhëzimit Administrativ për Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension<sup>4</sup>, konkretisht botimi në Web of Science dhe Scopus shpaguehet me një mijë euro (1000€) për punim.

Ndërkaq, botimi në revistat dhe platformat e indeksuara sipas të njëjtit udhëzim administrativ, konkretisht botimi në EBSCO, WorldCat dhe DOAJ shpaguehet me pesëqind euro (500€) për punim.

<sup>3</sup> Rregullore për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, 2020, linku: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1580737247-Rregullore%20p%C3%ABr%20Veprimtarin%C3%AB%20K%C3%ABrkimore%20-%20Shkencore.pdf>

<sup>4</sup> Udhëzimi Administrativ për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nderkombetare-me-recension.pdf>


## NUMRI I PUBLIKIMEVE SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS

Bazuar në CV-të dhe dokumentet tjera të publikuara në uebfaqe të universitetit, profesorët e Universitetit të Gjakovës që nga viti 2006 kanë publikuar në total 59 punime të vlefshme për avancim akademik – pra si autor i parë apo korrespondent.

Ndërkaq numri i punimeve ku kanë marrë pjesë edhe profesorët që nuk janë autor i parë apo korrespondent është 95.

Nga 26 profesorë të Universitetit të Gjakovës, 14 apo 54% nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë apo korrespondent. Në Universitetin e Prishtinës janë 186 (39%) profesorë që nuk kanë asnjë punim të botuar, në Universitetin e Prizrenit janë 31 (55%), dhe në Universitetin e Pejës janë 22 (66%).

### NUMRI I PUBLIKIMEVE NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS PËRGJATË VITEVE



Fakulteti me më së shumti punime në revista shkencore është Fakulteti i Mjekësisë. Numri total i punimeve në këtë fakultet është 66 me mesatarisht 9.4 punime për kokë profesori. Krahasimisht, në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës janë 7.09 punime për kokë profesori në vitin 2019. Në këtë fakultet janë evidentuar 35 punime në revista shkencore si autor i parë apo korrespondent.

Fakulteti me më së paku punime të botuara në revista shkencore është Fakulteti i Filologjisë me vetëm 2 punime të evidentuara.

Mesatarja e punimeve në nivel universiteti është 3.65 punime për profesor. Në Universitetin e Prishtinës janë 4.26 punime për kokë profesori pa marrë parasysh radhën e autorësisë, dhe në Universitetin e Prizrenit janë 1.17. Mesatarja e punimeve të vlefshme për avancim, pra si autor i parë apo korrespondent, është 2.3 punime për kokë profesori. Në Universitetin e Prishtinës janë 3.06 punime për kokë profesori si autor të parë ose korrespondent, në Universitetin e Prizrenit janë 0.98, dhe në Universitetin e Pejës janë 0.7.

#### PUBLIKIMET SHKENCORE PËR PROFESOR

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Gjakovës	Nr. i publikimeve	Nr. i profesorëve	Punime për profesor
1	Fakulteti i Edukimit	27	12	2.3
2	Fakulteti i Mjekësisë	66	7	9.4
3	Fakulteti i Filologjisë	2	7	0.3
<b>TOTAL</b>		<b>95</b>	<b>26</b>	<b>3.65</b>

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Gjakovës	Totali i profesorëve pa asnjë punim shkencor	Totali i profesorëve
1	Fakulteti i Edukimit	8 (67%)	12
2	Fakulteti i Mjekësisë	1 (14%)	7
3	Fakulteti i Filologjisë	5 (71%)	7
<b>TOTAL</b>		<b>14 (54%)</b>	<b>26</b>

## PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA


Nga 26 profesorët e Universitetit të Gjakovës, 15 apo 58% kanë publikuar në revista të dyshimta. Numri i punimeve të tilla në nivel universiteti është 33. Fakulteti me më së shumti publikime në revista të dyshimta është Fakulteti i Edukimit me 17 sosh.

### BOTIMET NË REVISTA TË DYSHIMTA

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Gjakovës	Numri i punimeve	Numri i profesorëve
1	Fakulteti i Edukimit	17	7
2	Fakulteti i Mjekësisë	10	3
3	Fakulteti i Filologjisë	6	5
<b>TOTAL</b>		<b>33</b>	<b>11</b>

Vitet 2016 dhe 2017 janë vitet me më së shumti publikime në revista të dyshimta. Ndërsa nga viti 2018 e tutje ka rënie të publikimeve në revista të tilla.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA




## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Nga 26 profesorë në Universitetin e Gjakovës, 17 apo 65% nuk i justifikojnë titujt akademikë sipas kriterit të punimeve shkencore si autor i parë apo korrespondent. Për krahasim, mosjustifikimi i titujve në Universitetin e Prishtinës në vitin 2019 është 55%, në Universitetin e Pejës mosjustifikimi është 70% dhe në Universitetin e Prizrenit mosjustifikimi i titujve është 64%.

Nga 13 profesorët asistentë, 8 prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë. Tek profesorët e asocuar, mosjustifikimi i titujve është 5 nga 12 profesorë të asocuar gjithsej. Në këtë universitet është një profesor i rregullt që nuk e justifikon titullin akademik.

### JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS

● E justifikojnë ● Nuk e justifikojnë



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Gjakovës	Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
		Prof. ass	Prof. asoc.	prof. rreg	Prof. ass	Prof. asoc.	prof. rreg
1	Fakulteti i Edukimit	2	1	0	5	3	1
2	Fakulteti i Mjekësisë	2	3	0	1	1	0
3	Fakulteti i Filologjisë	1	0	0	2	4	0
<b>TOTAL</b>		5	4	0	8	8	1
		(38%)	(33%)	(0%)	(62%)	(67%)	(100%)



# FAKULTETI I EDUKIMIT




- 12** profesorë me tituj akademikë
- 1** profesor i rregullt
- 4** profesorë të asocuar
- 7** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Profesorët në Fakultetin e Edukimit kanë publikuar në total 27 punime në revista shkencore. Prej tyre 22 janë të vlefshme për avancim akademik, pra si autor i parë apo korrespondent. 8 profesorë në këtë fakultet nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë apo korrespondent.

### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E EDUKIMIT



7 profesorë kanë botuar 17 punime në revista të dyshimta. Viti 2016 shënon vitin me më së shumti punime në revista të tilla, me 5 sosh. Në vitet në vijim ka rënie, ku në vitin 2019 janë dy të tilla.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 12 profesorëve, 9 apo 75% nuk i justifikojnë titujt akademikë sa i përket kriterit për publikime në revista shkencore si autor i parë apo korrespondent. Nga 7 profesorët asistentë, 5 prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë. Nga 4 profesorët e asocuar, 3 prej tyre nuk i justifikojnë titujt. Në këtë fakultet është një profesor i rregullt i cili nuk e justifikon titullin akademik.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Profesorët asistentë	Profesorët e asocuar	Profesorët e rregullt	Profesorët asistentë	Profesorët e asocuar	Profesorët e rregullt
2	1	0	5	3	1
3 (25%)			9 (75%)		

# FAKULTETI I MJEKËSISË




- 7** profesorë me tituj akademikë
- 4** profesorë të asocuar
- 3** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Profesorët në Fakultetin e Mjekësisë kanë publikuar në total 66 punime në revista shkencore. Prej tyre 35 janë të vlefshme për avancim akademik, pra si autor i parë apo korrespondent. Viti 2013 është viti me më së shumti punime, me 11 sosh. Një profesor në këtë fakultet nuk ka asnjë punim të publikuar si autor i parë apo korrespondent.

### PUBLIKIMI SHKENCOR



3 profesorë kanë botuar 10 punime në revista të dyshimta. Më së shumti punime të tilla ka në vitin 2017, me 5 të tilla.

### PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 7 profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë, 2 apo 29% nuk i justifikojnë titujt akademikë sa i përket kriterit për publikime në revista shkencore si autor i parë apo korrespondent. Nga 3 profesorët asistentë, 1 prej tyre nuk e justifikon titullin akademik. Nga 4 profesorët e asocuar, 1 nuk e justifikon titullin.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Profesorët asistentë	Profesorët e asocuar	Profesorët e rregullt	Profesorët asistentë	Profesorët e asocuar	Profesorët e rregullt
2	3	0	1	1	0
5 (71%)			2 (29%)		

# FAKULTETI I FILOLOGJISË




- 7** profesorë me tituj akademikë
- 4** profesorë të asocuar
- 3** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR

Profesorët në Fakultetin e Filologjisë kanë publikuar vetëm 2 punime në revista shkencore, të dyja të vlefshme për avancim akademik. Punimet janë në vitet 2009 dhe 2014. 5 profesorë në këtë fakultet nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë apo korrespondent.

5 profesorë kanë botuar 6 punime në revista të dyshimta. Viti 2016 shënon vitin me më së shumti punime të tilla, me 3 sosh.

### BOTIME NË REVISTA TË DYSHIMTA



## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 7 profesorëve, 6 apo 86% nuk i justifikojnë titujt akademikë sa i përket kriterit për publikime në revista shkencore si autor i parë apo korrespondent. Nga 3 profesorët asistentë, 2 prej tyre nuk e justifikojnë titullin akademik. Asnjë prej 4 profesorëve të asocuar nuk e justifikojnë titullin.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Profesorët asistentë	Profesorët e asocuar	Profesorët e rregullt	Profesorët asistentë	Profesorët e asocuar	Profesorët e rregullt
1	0	0	2	4	0
1 (14%)			6 (86%)		

# METODOLOGJIA

## Baza ligjore

- ① Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës<sup>5</sup>
- ② Statuti i Universitetit të Gjakovës, gjegjësisht Nenet 155, 156 dhe 157<sup>6</sup>
- ③ Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension<sup>7</sup>
- ④ Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi -I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension.<sup>8</sup>
- ⑤ Rregullore për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”<sup>9</sup>

ORCA ka bërë shqyrtimin e publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare, të përcaktuara si kriter nga Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, Statuti i Universitetit të Gjakovës për zgjedhje në njërën nga titujt akademikë: profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt, Udhëzimet Administrative 01/2018 dhe 07/2018, si dhe Rregullorja për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Gjakovës.

5 Ligji për arsimin e lartë, 2011, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761>

6 Statuti i përkohshëm i Universitetit publik të Gjakovës, 2013, linku: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/99762-Statuti%20i%20Perkohshem.pdf>

7 Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, linku: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nderkombetare-me-recension.pdf>

8 Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi -I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, linku: [http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revistat-nderkombetare\\_1.pdf](http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revistat-nderkombetare_1.pdf)

9 Rregullore për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”, 2019, linku: <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/1580739498-Regullore%20per%20Procedurat%20%20P%C3%ABrzgjedh%C3%ABse%20%20lidhur%20me%20Emrimin,Riemrimin%20dhe%20Avancimin%20e%20Personeli%20Akademik%20ne%20UGJFA.pdf>

## OBJEKTI I SHQYRTIMIT

Janë shqyrtuar CV-të e 26 anëtarëve të stafit profesorial në 3 fakultetet e Universitetit të Gjakovës. Këtu nuk përfshihen asistentët, ligjëruesit, lektorët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të cilët nuk i kanë titujt akademikë profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt. Përveç CV-ve janë shqyrtuar edhe listat e publikimeve shkencore për secilin fakultet të vendosura në uebfaqen e universitetit si dhe publikimin e Universitetit të Gjakovës të titulluar Buletini Shkencor 1.

## PERIUDHA E MBLEDHJES SË MATERIALIT PËR HULUMTIM

Të gjitha CV-të e shqyrtuara si dhe dokumentet tjera janë marrë në uebfaqen zyrtare të Universitetit të Gjakovës [www.uni-gjk.org](http://www.uni-gjk.org)<sup>10</sup>, gjatë muajt prill dhe maj të vitit 2020. Për arsye të saktësisë së të dhënave, këto CV i janë nënshtruar rishqyrtimit gjatë muajt tetor 2020. Të gjitha ndryshimet që janë evidentuar gjatë rishqyrtimit janë aplikuar përshtatshëmrisht në bazën e të dhënave të hulumtimit mbi të cilin është ndërtuar ky raport.

---

<sup>10</sup> Uebfaqja zyrtare e Universitetit të Gjakovës, linku: <https://uni-gjk.org/>



## LLOGARITJA E JUSTIFIKIMIT TË TITUJVE AKADEMIK

Për pozitën profesor asistent, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën një punim shkencor në revista shkencore ndërkombëtare me recension, relevante sipas Statutit të Universitetit të Gjakovës, si autor të parë apo korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 1.

Për pozitën profesor të asocuar kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën tri punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante, sipas Statutit të Universitetit të Gjakovës, si autor të parë apo korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 3.

Për pozitën profesor të rregullt, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën pesë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante, sipas Statutit të Universitetit të Gjakovës, si autor të parë apo korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 5.

Duke u bazuar në UA1/2018, UA7/2018 dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Gjakovës, ORCA ka vendosur koeficiente për secilin punim. Këto koeficiente janë vendosur përkatësisht sipas databazave ku janë të indeksuara revistat me koeficientet 1, 0.85 apo 0.70, apo sipas revistave të listuara në rregullativat e përmendura me koeficient 0.55.

ORCA i ka barasvlerësuar me koeficient 0 punimet e publikuara në përmbledhje konferencash, raportet, projektet, librat apo kapituj librash të cilat nuk janë revista shkencore ndërkombëtare, si dhe punimet të cilat janë në proces të publikimit, apo punimet për të cilat autorët kanë marrë çfarëdo konfirmimi nga revista përkatëse, por që nuk janë publikuar.

Publikimet në revista shkencore vendore dhe të vendeve fqinje, janë barasvlerësuar me koeficient 0.

Publikimet në revista të listuara si të dyshimta apo që botuesin e kanë të listuar si të dyshimtë janë barasvlerësuar me koeficient 0 dhe janë numëruar për nevoja të këtij humltimi.

## LLOGARITJA E NUMRIT TË PUBLIKIMEVE SHKENCORE

Pas hulumtimit të CV-ve, publikimet shkencore të gjetura në revista sipas rregullativave të përmendura, janë krahasuar mes secilit profesor brenda fakultetit, për të eliminuar dyfishimin e tyre. Në këtë numër janë përfshirë të gjitha punimet shkencore të botuara në revista valide, pavarësisht rangut të autorësisë, ndryshe nga analiza e justifikimit të titujve ku janë llogaritur vetëm publikimet në të cilat profesorët e Universitetit të Gjakovës figurojnë si autorë të parë apo korrespondent.



DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit “Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë - QAINT”. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

WITH FUNDING FROM  
 AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministristvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologji  
Ministry of Education, Science and Technology

